

VENDIM
Nr. 563, datë 4.10.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 87, DATË 14.2.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË GAZIT NATYROR NË SHQIPËRI DHE
IDENTIFIKIMIN E PROJEKTEVE PRIORITARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, 2 e 4, të nenit 5, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në dokumentin “Instrumenti lehtësues për projektet e infrastrukturës (IPF), asistenca teknike 4 (IPF 4) – WB11-ALB-ENE-01, Masterplani i Infrastrukturës së Gazit, raporti përfundimtar”, bashkëlidhur vendimit nr. 87, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3.2, me titull “Konteksti brenda sektorit të gazit dhe strategjitë përkatëse”, paragrafi i pestë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shoqëria TAP AG do të ndërtojë dhe do të operojë gazsjellësin TAP. Shqipëria, Greqia dhe Italia kanë nënshkruar një marrëveshje ndërqeveritare për TAP-in. Në bazë të vendimit të përbashkët të enteve rregullatore të energjisë të Italisë, Shqipërisë dhe Greqisë, më qershor 2013, TAP AG është e detyruar të ndërtojë të paktën një pikë daljeje me dy drejtime (bidireksionale) në Shqipëri (që gjendet në Fier), me një kapacitet prej 2–10 mmk/ditë (0,73–3,65 bmk/vit). Përveç Fierit, një pikë e dytë daljeje është në diskutim në zonën e Kuçovës.”.

2. Në pikën 5.6, nënndarja e parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Presioni maksimal i lejuar:

- 82 bar, për seksionet e IAP dhe deri në 100 bar për pjesën tjetër të sistemit të transmetimit në Shqipëri;

- Deri në 100 bar, për sistemin e transmetimit në Shqipëri kur IAP nuk ekziston.”.

3. Në pikën 9 bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në listën e prioriteteve në terma afatshkurtër shtohet nënndarja 2/1, me këtë përmbajtje: “2/1. Zhvillimi i pikës së daljes dhe rrjetit të shpërndarjes Bashkia Korçë”.

b) Në listën e prioriteteve në terma afatmesëm shtohet nënndarja 4/1, me këtë përmbajtje: “4/1. Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së gazit të lëngshëm natyror”.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministritë e institucionet përgjegjëse, të përmendura në planin e zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama